



Prishtinë: 06.04.2020
Kodi i ZRRE-së: V_1247_2020

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_2037_02_20**;
- Ankesa e konsumatorit e datës **14.02.2020**.

në seancën e mbajtur më datë 06.04.2020, nxori këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** ankesa e konsumatorit Y. Sh. nga Prishtina, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.
- II. **MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. **ZRRE/DMK_V_2037** i datës 05.02.2020.

A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji me datë 14.02.2020 ka pranuar ankesën e parashtruar nga konsumatori Y.Sh. i cili ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE si vendim i shkallës së parë. Konsumatori në ankesën e tij ka theksuar se vendimi i organit të shkallës së parë është vendim i padrejtë. Konsumatori në ankesë ka theksuar se gjatë muajit korrik për 10 ditë nuk kanë qënë në shtëpi (prej 04- 14) nuk ka pasur rrymë përderisa ditëve tjera ka pasur shpenzim normal. Konsumatori ka theksuar që t'i shqyrtohet ankesa e tij edhe njëherë dhe t'i hiqet ai mbi faturim.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 06.04.2020 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuar nga palët në kontest si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Sa i përket pikës së kundërshtimit të konsumatorit se vendimi i organit të shkallës së parë është vendim i padrejtë, Bordi i ZRRE thekson se kjo nuk qëndron pasi që vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete, dhe kjo vërtetohet edhe nga konstatimet e bëra në vendimin e organit të shkallës së parë të ZRRE.

Sa i përket pikës së kundërshtimit të konsumatorit se gjatë muajit korrik për 10 ditë nuk kanë qënë në shtëpi (prej 04- 14) nuk ka pasur rrymë përderisa ditëve tjera ka pasur shpenzim normal, Bordi i ZRRE thekson se bazuar në analizën e rrjedhës se energjisë elektrike konstatohet se konsumatori ka lexime dhe faturime të rregullta mujore. Bordi i ZRRE-së ka analizuar me kujdes shpenzimet e konsumatorit, ku ka analizuar shpenzimet e periudhës korrik 2018 dhe gusht 2018 si dhe ka bërë krahasime me



shpenzimet e periudhave të njëjta të mëhershme dhe të mëvonshme, dhe se konstaton se konsumatori në këtë periudhë është faturuar me shpenzime me të larta, por që gjatë analizës së bërë shpenzimeve nuk ka rezultuar se kjo të jetë si rrjedhojë e mos leximeve të sakta.

Bordi i ZRRE ka analizuar me kujdes edhe listat e leximit të KEDS për periudhën 04/2018 deri më 12/2018 dhe konstaton se konsumatorit i janë bërë lexime të rregullta përmes AMR-së (leximit në distancë) përveç periudhës kontestuese 07/2018 kur konsumatori është faturuar përmes programit ë faturimit.

Bordi i ZRRE thekson se gjatë analizave të bëra shpenzimeve të konsumatorit edhe për periudhat e me vonshme nga shtatori 2018 konstaton se konsumatori ka një rënie të shpenzimit krahasuar me periudhat 07/08/2018 dhe se këto shpenzime përputhen plotësisht me shpenzimet e konsumatorit, e që kjo vërteton se njehsori nuk ka pasur çrregullime në matje, pasi që kjo do të kishte reflektuar edhe në shpenzimet e mëvonshme. Për këtë Bordi i ZRRE-së bazuar në atë që periudhat korrik dhe gusht 2018 kanë pasur shpenzim më të lartë se shpenzimet tjera të periudhave tjera ka bërë shpërndarjen e shpenzimit të energjisë elektrike kWh të faturuara për periudhën korrik 2018 për periudhën gjashtë mujore 02/2018 deri me 07/2018 dhe ka rezultuar që konsumatorit nuk i takon korrigjim, e që kjo shpërndarje e shpenzimit të energjisë elektrike gjatë kësaj periudhe, përputhet plotësisht me mesataren e shpenzimit të energjisë elektrike para dhe pas kësaj periudhe

Bordi i ZRRE gjatë analizimit të të gjitha shkresave të lëndës konstaton se konsumatori ka lexime dhe faturime të rregullta mujore, dhe se me asnjë provë nuk është vërejtur ndonjë gabim në lexim. Andaj Bordi i ZRRE konstaton se KEDS/KESCO kanë respektuar nenin 28 paragrafin 1 dhe 2 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji ku thuhet se:” **1. Furnizuesi është i detyruar të sigurojë që konsumatorët të jenë të faturuar për energjinë e shfrytëzuar dhe për taksat e tjera, në përputhje me llojin e tarifës të dakorduar me Konsumatorin (nëse është e aplikueshme). 2. Faturimi i energjisë së shpenzuar zbatohet për çdo periudhë të faturimit duke u bazuar në të dhënat e lexuara nga njehsori dhe të mbledhura nga Furnizuesi ose Operatori i Sistemit për konsumatorët me tarifa të rregulluara në bazë të tarifave të miratuara nga ZRRE-ja, dhe për konsumatorët e kualifikuar (me çmime të parregulluara) ashtu siç është rënë dakord në kontratën për furnizim”.** Pra Bordi i ZRRE konstaton se vendimi i organit të shkallës së parë me të cilën është refuzuar ankesa e konsumatorit është e saktë, i drejtë dhe i bazuar në prova.

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se konsumatori në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 06.04.2020 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.



Bordi i ZRRE-së:

Arsim Janova, u.d. kryesues

Besim Sejfijaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Konsumatorit Y.Sh.
- KESCO-së, dhe
- Arkivit të ZRRE-së.